



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Bashkia Lezhë, L. Skenderbeg, Sh. "Gjergj Kastrioti", 4501, Lezhë, e-mail: f.frrokaj@lezha.gov.al, web: www.lezha.gov.al

Nr. 3239 Prot

Lezhë, me 25.04/2017

LENDË: KERKESE PER KONTROLLIN E PERPUTHSHMERISE SE DRAFTIT TE
PPV-se BASHKISE LEZHE.

DREJTUAR: AKPT-se

Adresa: Rruga Muhamet Gjollësia, TIRANË

Ne zbatim te ligjit nr. Nr.107/2014 , neni 9, 'PËR PLANIFIKIMIN E TERRITORIT', i ndryshuar, po ju ridergojme per kontrollin e perputhshmerise draftin e PPV- se Bashkise Lezhe , te hartuar nga studio e projektimit te kontraktuar nga Qeveria Shqiptare,(UTS-01) .

Bashkengjitur eshte shkresa nr. 376/1 date 20/04/2017 e ardhur nga AKMZ-ja , ne te cilen shpreh dakortesine e vet , si edhe praktika shoqeruese e derguar nga Bashkia Lezhe.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin,

KRYETARI

FRAN FRROKAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA
DREJTORIA E MENAXHIMIT, PROJEKTEVE DHE MONITORIMIT

Nr 376/Prot.

Tiranë, më datë 20 . 04 . 2017

Drejtuar: ✓ **Z. Fran FRROKAJ**
Kryetar
Bashkia Lezhë

Për dijëni: **Znj. Adelina GRECA**
Dejtoreshë e Përgjithshme
Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit

Z. Pjetër TONI
Drejtore
Administrata e Zonave të Mbrojtura, Lezhë

Lënda : Kthim përgjigje

I nderuar z. Frrokaj,

Në përgjigje të shkresës Nr. 2828. Prot., datë 11. 04. 2016 “Kërkesë për konfirmim”, nga bashkia Juaj, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, ju sqaron sa më poshtë vijon:

Në funksion të takimit të realizuar në ambjentet e AKPT-së, datë 14.02.2017, ku ishin të pranishëm përfaqësuesit e bashkisë Tuaj, përfaqësues të AKPT-së dhe Agjencisë tonë (AKZM), u diskutua mbi Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) të bashkisë Lezhë dhe ndërkohë edhe për zonat (sipërfaqet) që janë pjesë e zonave të mbrojtura (ZM). Nga diskutimi u dakortësua për të vazhduar me planin duke pasur parasysh përfshirjen e një zone zhvillimi në pronësi të bashkisë në kufij të zonës së mbrojtur dhe mosvazhdimi i ndërtimeve përtej godinës së fundit në drejtim të Monumenti të Natyrës “Rana e Hedhur”, duke marrë në konsideratë vijën kufizuese të territorit të bashkisë tuaj dhe në përputhje me vijën kufizuese të zonave të mbrojtura.

Përsa paraqitni në dokumentacionin e dërguar, AKZM-ja shprehet dakort me ndryshimet e bëra në hartën bashkëlidhur shkresës tuaj, por kërkon që ndryshimet e bëra të dërgohen me sistemin e gjeoreferuat të koordinatave.

Ju faleminderit për bashkëpunimin,


Zamir DEDEJ
Drejtore i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Bashkia Lezhë, L. Skenderbeg, Sh. "Gjergj Kastrioti", 4501, Lezhë, e-mail: f.frokaj@lezha.gov.al, web: www.lezha.gov.al

Nr. 2823 Prot.

Lezhe, me 11/04/2016

LËNDA: KERKESE PER KONFIRMIM

DREJTUAR : Z.ZAMIR DEDEJ

DREJTOR I AGJENSISE KOMBETARE TE ZONAVE TE MBROJTURA

TIRANË


I nderuar Z. Drejtor!

Ne takimin e realizuar me dt.14.02.2017 ne ambientet e Agjensise Kombetare te Plafikimit te Territorit Tirane , me pjesemarrjen e perfaqesuesve te Bashkise Lezhe, te Drejtorise se Pegjithshme te Zonave te Mbrojtura dhe te Agjensise Kombetare te Plafikimit te Territorit ku u diskutua per hartimin e Planit te Pergjithshem Vendor te Bashkise Lezhe , bazuar ne ligjin nr.139/2015 "Per Veteqeverisjen Vendore " , ligjin nr. Nr.107/2014 , "Per Planifikimin e Territorit" , VKM nr. 408 date 13.05.2015 " Rregullorja e Planifikimit te Territorit" , kerkojme nga ana Juaj konfirmimin e hartes te cilen po jua dergojme bashkengjitur kesaj shkrese , per te cilen eshte rene dakort gjate takimit te realizuar . Dergimi i ketij materiali eshte i domosdoshem per perfundimin e procedurave per hartimin dhe miratimin e Planit te Pergjithem Vendor .

Duke Ju falenderuar per bashkepunimin dhe mirekuptimin

KRYETARI

FRAN FRROKAJ



Konc. Sokol Toma

